



INFORMACIONE

PASQYRA E AKTIVITETEVE TE MUAJIT SHKURT

7 Shkurt
KOKSH & Agjensitë e UN

16 Shkurt
KOKSH & Komiteti për Mundësi të Barabarta

18 Shkurt
KOKSH – UNCRT & Partnerët

23-24 Shkurt
Vizitë e përfaqësuesit të CIO, Katia Mascagnani dhe ILO, Giovanni Di Cola

23 Shkurt
KOKSH & Komiteti për Mundësi të Barabarta
Tryezë e rumbullakët

24 Shkurt
Takime të tjera të vizitës se përfaqësuesve të CIO dhe ILO



“SPORTI, BARAZIA GJINORE DHE ZHVILLIMI”
Tryezë e Rrumbullakët



PERFAQESUESIT E CIO DHE ILO
VIZITE PUNE NE KOKSH

7 Shkurt - KOKSH & Agjensitë e UN

Në përgatitjet mbi përcaktimin e një kalendari për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për rininë, mbi mënyrat e koordinimit dhe ndjekjes, gjithashtu edhe mbi rënieën dakort për rolin dhe përgjegjësitë e të gjithë partnerëve të përfshirë në projekt, i cili do t'i paraprijë shpalljes së përbashkët të « **2005 - Viti Ndërkombëtar i Sportit dhe Zhvillimit** », Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, ka marrë pjesë aktive në një takim pune zhvilluar në zyrat e UNDP në Tiranë me përfaqësues të agjensive të Kombeve të Bashkuara dhe partnerët e tyre në Shqipëri.

16 Shkurt
KOKSH & Komiteti për Mundësi të Barabarta

Sekretari i përgjithshëm Stavri Bello zhvilloi një takim pune me Drejtoreshën e Komitetit për Mundësi të Barabarta, Nora Malaj, lidhur me mundësitë e ardhshme të bashkëpunimit, si dhe më konkretisht, mbi bashkëpunimin e afërt të një tryezë të rrumbullakët me temë : « **Sporti, Barazia Gjinore dhe Zhvillimi** ».

18 Shkurt KOKSH – UNCRT & Partnerët

Në mjediset e “Hotel Grant” nën koordinimin e UNCRT (Zyrës Koordinative të Agjensive të Kombeve të Bashkuara) KOKSH ka kënaqësinë të jetë pjesë e këtij rrjeti i cili do të funksionojë në kuadër të Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit (MDG) në Shqipëri. Një takim i rëndësishëm, për një partneritet ndërveprues gjatë gjithë vitit 2005, ku spikat « Sporti si një mjet për Zhvillimin » dhe për arritje e këtyre objektivave.

Institucionet partnerë në këtë rrjet janë :
MASH-Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MKRS(Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve)
DART (Drejtoria Arsimore e Rethit Tiranë)
UNICEF
ILO-IPEC
KOKSH (Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar)
UNFPA
UNDP
UNV
UNDP-LGP

23-24 Shkurt - Vizitë e përfaqësuesit të CIO, Katia Mascagnani dhe ILO, Giovanni Di Cola

Mbërrijnë në Shqipëri për një vizitë intensive 2 ditore pune, me ftesë të Sekretarit të Përgjithshëm i KOKSH, kanë ardhur në Shqipëri për një vizitë pune znj. Katia Mascagni, përfaqësues i CIO (Komiteti Olimpik Ndërkombëtar) dhe z. Giovanni Di Cola, përfaqësues i ILO (Zyra Ndërkombëtare e Punës). Përfaqësuesit e CIO dhe ILO zhvilluan një takim pune në zyrat e KOKSH ku u pritën nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi një bashkëpunim dhe mbështetje të Draft projektit pilot të hartuar nga KOKSH « **Zhvillimi i zonave rurale nëpërmjet sportit** ». Përveç kësaj, ishte edhe pjesëmarrja në tryezën e rrumbullakët mbi tematikën « Sporti, Barazia Gjinore dhe Zhvillimi ».

23 Shkurt
KOKSH & Komiteti për Mundësi të Barabarta –
Trezë e rrumbullakët

KOKSH dhe Komiteti për Mundësi të Barabarta organizuan në Hotel « Mondial » një tryezë të rrumbullakët mbi : « **Sporti, Barazia Gjinore dhe Zhvillimi** ». E drejtuar nga Presidenti i KOKSH z. Hysen Domi dhe Drejtoresha e Komitetit për Mundësi të Barabarta znj. Nora Malaj, me praninë e institucioneve të ndryshme kombëtare si MKRS, MASH, QKSHS, OJF të ndryshme dhe ato ndërkombëtare CIO dhe ILO, nëpërmjet diskutimeve kjo tryezë kishte për qëllim krijimin e mundësisë për dhënie e kontributit mbi një bashkërendim të aktiviteteve dhe mendimeve lidhur me tematika të Sportit, duke e parë sportin si një mjet drejt Barazisë Gjinore dhe Zhvillimit.



Përsa i përket organizatorëve, ky ishte hapi i parë i të punuarit së bashku, për tu përgatitur në realizimin e Konferencës së 3të Kombëtare “Femra & Sporti (Zhvillimi)”.

Disa nga rekomandimet e takimit që dolën nga diskutime ishin:

- Të promovohet në media lidhshipi grua
- Emisionet mediatike të shtohen në funksion të pjesëmarrjes në sport.
- Sporti si domosdoshmëri e njohjes së vlerave ku nuk ka moshë dhe gjini.
- Aktivitete të përbashkëta në partneritet me bashkitë. Etj.

Asistuan në këtë tryezë Edmond Dragoti zv. Ministër i MKRSs, Katia Mascagni (IOC-Komiteti Olimpik Ndërkombëtar) dhe Giovanni Di Cola (ILO–Zyra Ndërkombëtare e Punës).

24 Shkurt Takime të tjera të vizitës së përfaqësuesve të CIO dhe ILO

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, përfaqësuesi i ILO, Giovanni Di Cola dhe CIO, Katia Mascagni zhvilluan një takim pune me Presidentin dhe Sekretarin e Federatës Shqiptare të Taekwondos mbi mundësinë e përfshirjes së sportit të Taekwondos në realizimin e projektit « *Zhvillimi nëpërmjet sportit* ». Si ILO ashtu edhe CIO, siguruan mbështetjen dhe vëmendjen e tyre ndaj projekteve të KOKSH, iniciativave të ardhëshme, dhe ndërmjetësimit për arritje të mëvonshme.

Në vijim vizitës dy ditore të punës, në shoqërimin e Stavri Bello (KOKSH) dhe z. Alfred Topi (ILO – Albania), Giovanni Di Cola dhe Katia Mascagni, zhvilluan një takim pune në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale, të Pritur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kësaj Ministrie, z. Spartak Gjini.

Ngushëllim:

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar i shpreh ngushëllimet Familjes dhe të Afërmve të z. Vajdin Lamaj, njëkohësisht edhe Federatës Shqiptare të Boksit për humbjen e parakohshme të të shtrenjtit të tyre, si dhe të Presidentit të Federatës së Boksit, z. **Vajdin Lamaj**. Shprehim ngushëllimet, për këtë humbje të Thellë.

Në shenjë Solidarizimi dhe Respekti, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.

Ngushëllim:

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar i shpreh ngushëllime familjes, të afërmve dhe njëkohësisht Federatës së Çiklizmit për humbjen e parakohëshme të Trajnerit të mirënjohur të Klubit Vllaznia z. **Fuat Murriqi**. KOKSH solidarizohet në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për kontributin e dhënë në lëvizjen sportive.